

PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS (SYLLABUSI)

Niveli: Master Edukim Fizik dhe Sport

Lënda: Liderhipi dhe menaxhmenti në Edukim Fizik dhe Sport

Viti Akademik 2024/25

Viti i Studimeve: I

Semestri: I

Kreditet: 5 ECTS (European Credit Transfer and Accumulation System)

Ngarkesa: 2+1

Mësimdhënësi: Dr. Besim Halilaj

Kontakti: besim.halilaj@uni-pr.edu

Orari: E Premte, ora 10:50 – 12:10

Vendi: Amfiteater FEFS - Prishtinë

Përmbajtja e Lëndës:

Lënda ofron kompetencat e nevojshme për të menaxhuar ngjarjet sportive, të edukimit fizik dhe sportit duke përdorur të menduar kreativ dhe drejtë zgjidhjes së problemve si dhe aftësitë vendimmarrëse si strategji për t'i tejkaluar sfidat e parashtruara. Për më tepër, studentët do të marrin informata se si të udhëheqin, kontrollojnë dhe motivojnë studentët dhe sportistët. Në vazhdim, lënda do të ofrojë informata se si të organizohen dhe delegohen punët dhe detyrat dhe si të menaxhohen pozitivisht burimet njerëzore.

Qëllimi dhe rezultatet e pritura:

Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lëndë studentët do të jenë në gjendje të:

Të zhvillohen njohuri mbi teoritë dhe praktikat e liderhipit dhe menaxhimit në edukim fizik dhe sport.

Të analizohet roli i liderëve dhe menaxherëve në kontekstin e aktiviteteve sportive dhe edukimit fizik.

Të zhvillohen aftësi praktike për menaxhimin e grupeve dhe organizatave sportive.

Të kuptohet rëndësia e komunikimit efektiv dhe marrëdhënieve ndërpersonale në liderhipin sportiv.

Të identifikohen dhe zgjidhen sfidat dhe mundësitë në menaxhimin e aktiviteteve sportive.

Në vazhdim, lënda do të ofrojë informata se si të organizohen dhe delegohen punët dhe detyrat dhe si të menaxhohen pozitivisht burimet njerëzore.

Të përgatiten për zhvillimin e ekipit dhe motivimin e individëve.

Të bëhen efikas në planifikim strategjik dhe operacional si dhe të jenë në gjendje të analizojnë objektivat mjedisore dhe hapësirore.

Metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

Ligjerata, ushtrime, vizita në qendrat me nevoja të veçanta, punë individuale, detyra, punë grupore, etj.

Literatura:

- [Libri 1]: Menaxhimi i organizatave sportive olimpike, Solidariteti Olimpik- IOC, 2007.
- [Libri 2]: Sport administrator manual, Solidariteti Olimpik- IOC, 2010.
- Artikuj dhe burime të tjera të rekomanduara gjatë semestrit.
- Robert N. Lussier, David C. Kimball (2014). Applied Sport Management Skills. Human Kinetics.
- Ming Li, Eric W. Macintosh, Gonzalo A. Bravo (2012). International Sport Management. Human Kinetics.
- ACSM (2011). ACSM's Health/Fitness Facility Standards and Guidelines. American College of Sports Medicine. Human Kinetics.
- Menaxhimi i organizatave sportive olimpike – Solidariteti Olimpik – Komiteti Olimpik Nërkombehtar – Human Kinetics 2007.

Forma e vlerësimit:

Pjesëmarrja në ligjerata – 5%, përkushtimi 5%, prezantimet - 10%, testi i parë - 30%, vlerësimi final – 50%

Ps: Mungesa e plotësimi të kriterëve minimale nënkupton vlerën zero (0) në vlerësimin e vazhdueshëm.